Redaksia
13 Korrik, 10:08 | **Përditesimi: 13 Korrik, 10:25**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerbuma

Policia ka asgjësuar 374 bimë kanabis, në Lëzhë në kuadër të operacionit 'seven'

Në pranga është vënë autori i dyshuar 27 vjeçari Endri Çupi, ndërsa është shpallur në kërkim bashkëpuntori i tij Jetmir Marku, 33 vjeç.

Policia ka nisur edhe procedim penal ndaj kryebashkiakut të fshatit Batra për shpërdorim detyre.

LEXO EDHE:
Britani/ U kap në një fermë kanabisi, 26- vjeçari shqiptar dënohet me 12 muaj burg

Njoftimi i Policisë:

Mirditë/Vijojnë kontrollet intensive të territorit dhe hetimet proaktive, në kuadër të planit operacional kombëtar të koduar "Territor i Pastër".

Pas një hetimi proaktiv disajavor, finalizohet operacioni policor i koduar "Seven".

Asgjësohen 374 bimë kanabis sativa si dhe sekuestrohen dy armë gjahu.

Vihet në pranga autori i dyshuar, i cili u kap në flagrancë duke u kujdesur për bimët narkotike.

Identifikohet dhe vijon puna intensive për kapjen e bashkëautorit të kësaj veprimtarie kriminale.

Procedohen penalisht kryeplaku i fshatit Batra, për shpërdorim detyre.

Në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional kombëtar "Territor i Pastër", për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e tentativave për kultivimin e bimëve narkotike, Shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë kanë intensifikuar kontrollet në terren dhe hetimet proaktive të bazuara edhe në inteligjencën policore.

Në këtë kuadër, si rezultat i një hetimi disajavor në bashkëpunim me Prokurorinë Lezhë, shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë në bashkëpunim me Seksionin për Mbështetjen Operacionale të Hetimit në DVP Lezhë, finalizuan me sukses operacionin e koduar "Seven".

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë shtetasi:

** Endri Çupi, 27 vjeç, banues në fshatin Batra, njësia administrative Fan, bashkia Mirditë, i dyshuar për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike", e kryer në bashkëpunim.*

Ky shtetas dyshohet se në hapësirën e pyllit në afërsi të fshatit të tij në vendin e quajtur "Përroi Batrajve", kishte kultivuar në 7 parcela të ndryshme në distancë nga njëra tjetra, 374 bimë kanabis sattiva.

Gjatë operacionit, ky shtetas u kap në flagrancë në njërën nga parcelat duke u kujdesur për bimët narkotike në orët e vona të mbrëmjes.

Gjithashtu pas një pune intensive hetimore, është arritur të identifikohet i dyshuar si bashkëautor në këtë aktivitet kriminal, shtetasi Jetmir Marku, 33 vjeç, banues në fshatin Xhuxhë, njësia administrative Fan, bashkia Mirditë, i dyshuar për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike" e kryer në bashkëpunim ku vijon puna për kapjen e tij.

Në vijim të hetimeve proceduriale nga policia, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Endri Çupi, është sekuestruar një armë gjahu çifte pa leje si dhe është bërë bllokimi i po një arme tjetër gjahu me leje.

Në vijim të operacionit, u procedua penalisht për shpërdorim detyre shtetasi S. Gj., me detyrë kryeplak i fshatit Batra. Ky shtetas dyshohen se nuk ka kryer detyrën e tij funksionale, në zonën që mbulon.

Materialet në ngarkim të këtyre shtetasve i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

S.B/Shqiptarja.com

TAG: mirditë kanabis

Komentoj

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Finalja mes Spanjës dhe Anglisë, sipas jush kush e fiton Euro 2024?

Spanjë Anglì S'kam mendim

Lajme të tjera

Gjirokastër/ Kultivonte cannabis sativa në oborrin e banesës, 1 në pranga
10 Korrik, 10:44

Plantacion me kanabis në kufirin greko-shqiptar, asgjësohen rreth 2 mijë bimë (FOTO)
9 Korrik, 16:29

Velipojë/ Shisnin doza me kanabis në zonën bregdetare, 1 në pranga, 1 tjetër procedohet penalisht
8 Korrik, 11:01

Vau i Dejës/ Asgjësohen mbi 15 mijë fidanë e bimë kanabis, ende nuk dihen autorët
6 Korrik, 11:42

Shkodër/ Zbulohen 4 parcela me 14 200 fidanë kanabis! Vetëm në Shalë u asgjësuan 10 mijë bimë
5 Korrik, 09:52

Tritol në makinë, plagoset vëllai i kreut të bandës së Mirditës! Prej 20 vitesh asnjë gjurmë prej tij, në 2000 u dënua përjetë për vrasjen e një polici
30 Qershor, 10:07



Vlorë, asgjësohen 320 bimë kanabis, vihen në pranga 2 shtetas, një tjetër në kërkim
29 Qershor, 14:54

Plagosën 54 vjeçarin në Mirditë, në pranga 3 vëllezër (EMRAT)
25 Qershor, 12:05

Megaoperacioni 'Territor i pastër'/ Policia gjen dhe asgjëson 5396 fidanë dhe bimë kanabis në qarqet Lezhë, Elbasan dhe Shkodër
24 Qershor, 10:59

FOTO+VIDEO/ Qiramarrësit kthejnë banesën në 'shtëpi bari', pronari gjen 10 ton dhe në dhomën e gjurmit
23 Qershor, 17:35

Dënohen me burg 2 shqiptarët në Britani, kultivuan kanabis me vlerë 415 mijë paund (EMRAT+FOTO)
23 Qershor, 15:44

Vlorë/ Asgjësohen 168 bimë narkotike, vihet në pranga 51-vjeçari
21 Qershor, 11:26

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje